



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II nr.771/22

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkalles se Dytë ne Prishtinë, me gjyqtaren Franciska Zhitija-Ymeri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi" sh.a ne Prishtinë, rr."Bill Klinton" p.n, ndaj debitorit Telekom i Kosovës me seli ne Prishtinë-Depo ne Shkabaj, me bazë juridike-borxh, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.330/20 të datës 03.02.2021, me datë 05.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit Telekom i Kosovës me seli ne Prishtinë-Depo ne Shkabaj, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.330/20 të datës 03.02.2021, VËRTETOHET

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.330/20 të datës 03.02.2021, ka hedhur si të pasafatshëm prapësimin e debitorit Telekom i Kosovës me seli ne Prishtinë-Depo ne Shkabaj, të ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarimit P.nr.670/19 te datës 18.11.2019, për shkak të borxhit në shumë prej 378.72 euro.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, vërtetimit te gabuar te gjendjes faktike dhe aplikimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim që Gjykata e shkalles se dytë, ta aprovoj ankesën e debitorit, ta prish aktvendimin e kundërshtuar dhe ta pezulloj procedurën përmbarimore, ashtu qe çështjen ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, si gjykatë e shkallës së dytë, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), pas vlerësimit të ankesës dhe komplet shkresave të lëndës, ka gjetur se:

Prapësimi i debitorit është i pa afatshëm.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori ka paraqitur propozim për përmbarim, ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstraktit, lidhur me pagimin e borxhit në shumën prej 378.72 euro. Përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin me urdhrin P.nr.670/19 të datës

18.11.2019, ndaj të cilit urdhër debitori ka paraqitur prapësim me datën 20.02.2020. Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimin, vendosi si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar.

Dhoma e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore përcaktohet së: *“Prapësimi duhet të dorëzohet gjykatës brenda shtatë (7) ditësh pas pranimit të vendimit përmbartues ose urdhrit përmbartues”*, ndërsa me dispozitën e nenit 73 paragrafi 3, parashihet së: *“Me vendim prapësimi mund të pranohet, refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i palejuar”*.

Në këtë kontekst dhe në kuptim të kësaj dispozite, Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe ligjërisht ka vendosur kur e ka hedhur si të pa afatshëm prapësimin e debitorit, sepse nga fletë kthesa e cila gjendet në shkresat e lëndës konstatohet se debitori urdhrin për lejimin e përmbartimit e ka pranuar me datë 12.02.2020, ndërsa prapësimin ndaj këtij urdhri e ka paraqitur me datën 20.02.2020, nga del se prapësimi është paraqitur pas afatit ligjor dhe si datë e fundit për paraqitjen e prapësimin ka qenë data 19.02.2020, brenda të cilit afat debitori nuk ka vepruar.

Janë vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore nga ana e Gjykatës së shkallës së dytë, por nuk janë konsideruar të rëndësishme për të vendosur ndryshe sepse debitori nuk ka mundur ti provoj pretendimet e tij ankimore për afatshmërinë e prapësimin.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) e LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE-DHOMA E SHKALLES SE DYTË
K.DH.SH.II nr.771/22, me datë 05.09.2022

Gjyqtarja
Franciska Zhitija-Ymeri